



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .12.2024

MBLEDHJA Nr. 50,
Datë 10.12.2024, ora 10:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Martë, datë 10.12.2024, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 50 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 02.12.2024.
2. Mbi miratimin e datës së fillimit të tregtimit për tregun e ankandeve brenda së njëjtës dite në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.
3. Mbi kërkesën e OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për ndryshimin e afatit të nominimit në tregun e balancimit.
4. Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar.
5. Mbi shqyrtimin e kërkesës së Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) për disa ndryshime dhe kufizime në zbatimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 06.06.2023.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “VOLTON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

10. Mbi kërkesën e shoqërisë “EN.KU” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
11. Mbi kërkesën për njohjen e licencës për furnizimin e energjisë elektrike, lëshuar nga Agjencia për Energji e Republikës së Serbisë, për subjektin “ENERGOVIA” EOOD.
12. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, "Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror ALBGAZ” sh.a., i ndryshuar.
13. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI